



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 976/2021

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët: Afijete Sada Gillogjani kryesuese, Zyhdi Hajrizi dhe Kymete Kicaj anëtarë, duke vendosur përkitazi me apelin e kandidates për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Drenasit Filloreta Bujupi nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV) dega Drenas, paraqitur kundër vendimit me numër 2948/2021 i datës 03.11.2021, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për Shpalljen e Rezultateve përfundimtare për Zgjedhjet Lokale 2021, për Kuvendin Komunal, në seancën e panelit të mbajtur me datë 07.11.2021, mori këtë:

### V E N D I M

**REFUZOHET** i pabazuar apeli Anr.976/2021 i datës 04.11.2021 i parashtruar nga kandidatja për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Drenasit Filloreta Bujupi nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV) dega Drenas, paraqitur kundër vendimit me numër 2948/2021 i datës 03.11.2021, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për Shpalljen e Rezultateve përfundimtare për Zgjedhjet Lokale 2021, për Kuvendin Komunal, me të cilin ka kërkuar rinumërimin e votave.

### A r s y e t i m

PZAP-i, ka pranuar një apel me datën 04.11.2021 nga kandidatja për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Drenasit Filloreta Bujupi nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV) dega Drenas, me të cilën pretendon se në disa qendra të votimit ka pasur manipulim të votave nga kryesuesit dhe komisionerët andaj kërkon që të rinumërohen votat në këto qendra të votimit: në Qikatove Re 0320e/01R, 0320e/0R, 0320e/03D, Llapushnik 0317e/01R, 0317e/02R, 0317e/03R, 0317e/04D, Gillanasell 0316e/01R, 0316e/02D, Bajicë 0308e/01R, 0308e/02R, 0308e/03D, Terdec 0323e/01r, 0323e/02D, Arrllat 0313e/01R, 0313e/02R, 0313e/03R, 0313e/04D, Shkolla Rasim Kiqina 0301e/01R, 0301e/02R, 0301e/03R, 0301e/04R, 0301e/05D, Negroc 0314e/01R, 0314e/02D, Kishnarek 0321e/01R, 0321e/02D, shkolla Xheladin Gashi –Plaku 0302e/01R, 0302e/02R, 0302e/03R, 0302e/04R, 0302e/05D, Shkolla Halil Bajraktari 0301x/01R, 0301x/02R, 0301x/03R, 0301x/04D, Poklek 0315e/01R, 0315e/02D, Gradicë 0305e/01D

PZAP-i, pas shqyrtimit paraprak të besueshmërisë së apelit dhe vlerësimit të pretendimeve ankimore, që gjenden në shkresat e lëndës, në kuptim të nenit 117 paragrafi 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

**Apeli është i pabazuar**

Paneli, vlerëson se parashtruesi i apelit në mbështetje të pretendimeve të tij, nuk ka bashkangjitur asnjë lidhur me shkeljet e supozuara për manipulime të votave, edhe pse në kuptim të nenit 117 paragrafi 3 të LZP-së, barra e të provuarit bie mbi ankuesin, në rastin konkret, paneli, nuk mundi të konstatoj se ka pasur manipulime të votave, për faktin se thëniet e saj janë vetëm supozime të imagjinuara dhe jo të konkretizuara në asnjë provë konkrete bindëse andaj pala ankuese nuk i ka argumentuar shkeljet e pretenduara në apel.

Andaj, Paneli vlerësoi se apeli i parashtruar nga Filloreta Bujupi nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV) dega Drenas, nuk është i bazuar me asnjë dëshmi ashtu siç përcaktohet në dispozitat ligjore të LZP-së, pasi që nga shkresat e lëndës nuk mund të vërtetohet se ka ndodhur ndonjë shkelje apo parregullsi gjatë numërimit të votave.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia**  
**Anr.976/2021 më datën 07.11.2021**

**Kryesuesja e Panelit**  
**Afijete Sada Gillogjani**



***Këshilla Juridike:*** Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par.4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.